REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES**
**I.Numër:01-112/02-137816/21, datë: 22. Dhjetor 2021.**

Në bazë të nenit 11,nenit 12.2. pika d) dhe nenit 61 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazetazyrtare e Republikës sëKosovës, Nr.28.datë: 04. qershor 2008"), nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna dt. 21.09.2020, dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431, dt.30 Shtator 2020, në propozim të kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës në takimin e mbajtur me datë: 22. Dhjetor 2021, me shumicë votash të anëtarëve të kuvendit të komunës që janë shumicë dhe shumicën e votave të anëtarëve të kuvendit të komunës që i përkasin komunitetit joshumnicë, merr:

# VENDIM
## Nr.04/2021
## Mbi emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete

1.**Z.Mirzet Dzogović, EMËROHET Nënkryetar i Komunës së Pejes për Komunitete**, nga subjekti politik "Bosnjaçka Inisiciativa PEĆ" me qellim të promovimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë në komunën e Pejës.

2.Nënkryetari i komunës për komunitete, zgjidhet përmandat të njejtë si kryetari i Komunës.

3.Përgjegjësit e nënkryetarit të komunës për komunitete janë përcaktuar me nenin 61 paragrafi 4 të LVL-së, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.02/2020 për proceduren e emërimit të nënkrytarëve në komuna, dhe nenin 57 paragrafin 4 të Statutit të Komunës së Pejës, si dhe dispozitat të tjera ligjore.

4.Kompenzimi (pagamujore) është e përcaktuar me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesen e stafit politik në komuna, që përfshin deri në 60% të pages së kryetarit të Komunës.

5.Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës.

6.Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**
**Rexhep Kurtbogaj**

**Vendimi ti dërgohet:**
1x1. Kryetarit të Komunës.
1x1. Të emëruarit.
1x1. Zyrës së përsonelit.
1x1. DBF-ca
1x1. Arkivë.